

Llogaria e pagesës për shërbime bazike për klientët individë Me kushte standarde

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rruga Ismail Qemali, No. 27,
Kutia postare Box. 8319
1001 Tiranë, Albania
Tel: +355 4 22 76 000; +355 4 22 76 260 / 5; +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al.

Karakteristikat dhe rreziqet e "Llogarisë së Pagesës me Shërbime Bazike me kushte standarde"

Karakteristikat e Llogarisë së pagesës me shërbime bazike me kushte standarde

Llogaria e pagesës me shërbime bazike iu ofrohet të gjithë klientëve individë në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, historikut të aftësisë paguese të konsumatorëve brenda Republikës së Shqipërisë.

Llogaria e pagesës me shërbime bazike ofrohet për dy target grupe:

- 1) Llogaria e pagesës me shërbime bazike me kushte standarde, dhe
- 2) Llogaria e pagesës me shërbime bazike me kushte të lehtësuara.

Llogaria ofrohet vetëm në monedhën vendase Lekë.

Llogaria e pagesës me shërbime bazike:

- ofrohet vetëm në monedhën vendase (lekë) dhe për një individë të vetëm si titullar;
- nuk ka në asnjë moment një tepricë negative;
- nuk mundëson pagesat ndërkombëtare në monedhë të huaj;
- nuk mundësohet financimi me produkte kredie (të gjitha tipologjitë);
- nuk mundësohet në asnjë rast të tejkalojnë tepricën kreditore të Llogarisë;
- nuk mundësohet përdorimi i kësaj llogarie për të investuar në produkte depozite me afat, apo çdo formë tjetër investimi (p.sh.: Bono Thesari, Obligacione, etj.);
- nuk mundësohet kreditimi i të ardhurave nga paga.

Banka nuk mundëson ekzekutimin e transaksioneve të pagesave nëse në llogarinë e pagesës me shërbime bazike nëse nuk ka tepricë kreditore të mjaftueshme për të ekzekutuar një transaksion pagese dhe/ose aplikim tarife.

Tregu i synuar

Nëpërmjet kësaj llogarie mundësohet garantimi i së drejtës për aksesin në një llogari pagese me shërbime bazike për konsumatorët, si një mjet i domosdoshëm për të mundësuar pjesëmarrjen e konsumatorëve në tregun financiar, bazuar në interesin e tyre të vërtetë për të pasur një llogari të tillë, e cila do t'i lejojë ata të marrin përfitimet që sjell tregu financiar.

Përfitues të **Llogarisë së pagesës me shërbime bazike me terma të lehtësuara** janë të gjithë klientët individë që bëjnë pjesë në grupin e konsumatorëve, të cilët përfitojnë nga programet dhe politikat për skemat e ndihmës ekonomike dhe sociale sipas legjislacionit përkatës në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë listuar:

- a) përfituesit e pagesës së papunësisë sipas ligjit që rregullon nxitjen e punësimit në Republikën e Shqipërisë;
- b) familjet dhe individët, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike sipas ligjit që rregullon asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë;
- c) përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe ndihmësit personalë të tyre sipas ligjit që rregullon asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë;
- ç) individët përfitues të statusit të invalidit dhe ndihmësit personal të tyre sipas ligjit që rregullon statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në Republikën e Shqipërisë;
- d) individët përfitues të statusit të të verbrit dhe ndihmësit personal të tyre sipas ligjit që rregullon statusin e të verbrit në Republikën e Shqipërisë;
- dh) invalidët e punës sipas ligjit që rregullon statusin e invalidëve të punës në Republikën e Shqipërisë, për pagesën shtesë mbi pensionin e invaliditetit;
- e) jetimët që kanë përfituar statusin sipas ligjit që rregullon statusin e jetimit në Republikën e Shqipërisë;
- ë) përfituesit e masës së financimit për fëmijën e vendosur në familje kujdestare me vendim gjykatë;

f) përfituesit e pensionit social bazuar në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk plotësojnë kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk kanë të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social;

g) përfituesit e pensionit të pleqërisë sipas përcaktimeve në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

gj) përfituesit e invaliditetit, si dhe përfituesit e pensionit të invaliditetit të përhershëm për shkak të aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, sipas përcaktimeve në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

h) përfituesit e pensionit familjar sipas përcaktimit në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

i) përfituesit e ndihmës ekonomike për arsimin e lartë bazuar në listën e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Dokumentat e nevojshme

- 1- Pasaportë ose Kartë Identiteti të vlefshme;
- 2- Forma e vetë-deklarimit;
- 3- Kontrata e Llogarisë së pagesës me shërbime bazike;
- 4- Dokumentacioni i FATCA;
- 5- Cdo dokument tjetër i nevojshëm për klientët që aplikojnë për Llogari pagese me shërbime bazike me kushte të lehtësuara.

Rreziqet e Llogarisë së pagesës me shërbime bazike

1. Nëse klienti mbyll llogarinë e pagesës me shërbime bazike brenda 3 muajve, detyrohet të paguajë një komision. Klienti duhet të mbyll të gjitha produktet që lidhen me llogarinë e pagesës me shërbime bazike në rast se dëshiron të mbyllë atë;
2. Në rast se Banka vërteton se Klienti ka dhënë deklaratë të pavërtetë për hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike dhe ka një llogari pagesash në një bankë tjetër, Banka nuk i ofron Klientit të drejtën e hapjes së një llogorie pagesash me shërbime bazike për një periudhë kohore prej 24 muajsh;
3. Në rast se Banka konstaton se Klienti ka hapur llogari pagese në cilëndo bankë të licencuar në Republikën e Shqipërisë, Bankës i lind e drejta të kërkojë që për shërbimet/veprimet e kryera në llogarinë bankare, Klienti të paguajë tarifat e shërbimeve/veprimeve të kryera me efekt prapaveprues, që prej çastit kur Bankës i ka lindur kjo e drejtë e në përputhje me tarifat e saj në fuqi. Në këtë rast, Bankës i lind e drejta të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme dhe me efekt të menjëhershëm;
4. Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e Bankës së huaj deri në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

Opsione të tjera shtesë

Llogaria e pagesave me shërbime bazike përfshin shërbimet e mëposhtme:

1. shërbime që mundësojnë të gjitha operacionet e kërkuara për hapjen, funksionimin dhe mbylljen e saj;
2. shërbime që mundësojnë depozitimin e fondeve në një llogari pagesash;
3. shërbime që mundësojnë tërheqjen e fondeve nga një llogari pagesash brenda Shqipërisë në sportele ose në ATM (automated teller machines) gjatë ose jashtë orarit zyrtar të punës së bankave;
4. ekzekutimin e transaksioneve të mëposhtme të pagesave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë:
 - i. debitimet direkte;
 - ii. transaksionet e pagesave përmes një karte (përfshirë transaksionet e pagesave me karta krediti), përfshirë pagesat online;
 - iii. transfertat e kreditit, përfshirë pagesat periodike, aty ku është e zbatueshme, në terminale dhe në sportelet e bankës dhe nëpërmjet platformave online.

Shërbime suplementare

Shërbime shtesë që ofrohet me Llogarinë e pagesave për shërbime bazike janë:

- a) aksesimi në aplikacionin bankar DIGICAL;
- b) mundësia për të aksesuar llogarinë edhe nëpërmjet kartës së debitit Visa Inspire

Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

Shpenzime fikse mujore

Komisione për mbajtje llogarie	140 LEK/ muaj
Komisione për kartë debiti	55 LEK/ muaj
Komision per Software Token	Falas
Komisioni i lëshimit për Hardware Token	700 LEK / për përdorues
Komision për Shërbimin Bankar Dixhital	Falas
Njoftim përmes SMS	50 LEK/ muaj

Shpenzime të ndryshme

Nxjerrje llogarie*	100 LEK nxjerrje llogarie për muajin aktual;
*Klienti gëzon të drejtën që 1 herë në vit të marrë falas printimin e levizjes së llogarisë/ve	200 LEK nxjerrje llogarie për vitin aktual; 500 LEK nxjerrje llogarie për vite të mëparshme.
Dërgimi i levizjeve të llogarisë në mënyrë elektronike	Falas
Dërgimi i levizjeve të llogarisë në adresën e klientit	100 LEK/ zarf
Transaksione në ATM të Intesa Sanpaolo Bank Albania në Shqipëri	Falas
Tërheqje parash në sportelet e Bankës nga llogaria e pagesës me shërbime bazike	65 LEK për shumat deri në 50,000 LEK; Falas për shumat nga 50,000 LEK deri në 300,000 LEK; 150 LEK për shumat nga 300,000 LEK deri në 1,500,000 LEK; 0.10% (max. 2,000 LEK) për shumat mbi 1,500,000 LEK
Tërheqje parash në sportelet e bankës nga llogaria me këmbim	Falas për shumat deri në 300,000 LEK; 150 LEK për shumat nga 300,000 LEK deri në 1,500,000 LEK
Pagesa në cash në llogaritë e Thesarit/Buxhetit ose pagesa të faturave	150 LEK
Pagesa për Agjencia Shtetërore e Kadastres (AShK)	150 LEK
Interes për depozitimet	
Interes kreditor në Llogarinë e pagesës me shërbime bazike	N/A

Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Llogaria e pagesave me shërbime bazike është pa një kohëzgjatje të caktuar.

Llogaria e pagesave me shërbime bazike mbyllet në mënyrë të njëanshme nga Banka, duke njoftuar Klientin me shkrim, të paktën 2 (dy) muaj përpara, për mbylljen e llogarisë;

Mund të mbyllet nga Banka, në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme, në rast se:

- Klienti ka paraqitur informacion të pasaktë për të hapur llogarinë e pagesave me shërbime bazike;
- Klienti ka përdorur llogarinë e pagesave për qëllime të paligjshme;
- Klienti nuk gëzon më cilësinë e rezidentit në Republikën e Shqipërisë;
- Në bazë të ligjit, apo strukturave të autorizura nga ligji;
- Janë plotësuar kriteret dhe llogaria është klasifikuar si jo-aktive (dormant account), dhe Teprica Kreditore në llogari është zero; etj.

Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: complain@intesasanpaolobank.al.
- Në Qendrën e Kontaktit: **08006000**.

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorthi i Termave Kryesore

Specimen - Specimeni i nenshkrimit, eshte nje dokument i dedikuar ku personat qe jane te autorizuar te administrojne ose te nenshkruajne per nje llogari, do te depozitojne nenshkrimet e tyre ne banke. Bazuar ne nenshkrimin e depozituar, Banka do te lejoje disponimin e llogarise sipas urdhrave te personave te autorizuar te Klientit.

ASD- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".